



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2024

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 22/10/2024

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ose

Operatori Ekonomik “JUNIK” SHPK, me Nuis J68007522L dhe me adrese Lagjja “SMT”,
Ndertese 2-Kateshe, kati 2, prane Drejtorise Sherbimit Pyjor, Lezhe.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-21523-09-25-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rindertimi i Ures ne fshatin Koder Mulliri, Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 5 Muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 26/09/2024.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “JUNIK” SH.P.K, me Nuis J68007522L dhe me oferte ekonomike 14,079,514 (katërmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e nente mijë e pesëqind e katërmbëdhjetë) Lek pa Tvsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

2. Operatori Ekonomik “RAFAELO 2002” SH.A, me Nuis K22113003Q dhe me oferte ekonomike 14,426,106 (katërmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtë) Lek pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

II. Operatori Ekonomik “RAFAELO 2002” SH.A, me Nuis K22113003Q

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.2.1, të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi”*.

KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimin e xhiros për vitet financiare 2021,2022,2023 sipas kërkesës së pikës 2.2.1 të DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për xhiron vjetore duke mos përmbushur këto kriter.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.2.2, të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku*

bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 sipas kërkesës së pikës 2.2.2 të DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë bilanc vjetor duke mos përmbushur këto kriter.

Se, treti, nuk plotëson kriterin 2.3.1, 2.3.2, 2.3.8, 2.3.9 dhe 2.3.10, të kushteve të veçanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtyre kritereve.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nënën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe në nënën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “RAFAELO 2002” SH.A, me Nuis K22113003Q, për mos përmbushje të kritereve të veçanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “RAFAELO 2002” SH.A, me Nuis K22113003Q, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “JUNIK” SHPK, me Nuis J68007522L dhe me adresë Lagjja “SMT”, Ndertese 2-Kateshe, kati 2, pranë Drejtorisë

Sherbimit Pyjor, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 14,079,514 (katermbedhjete milion e shtatedhjete e nente mije e peseqind e katermbedhjete) Lek pa Tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU